



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQERIA RAJONALE UJESJELLES KANALIZIME FIER SH.A

Nr. _____ prot

Fier, më _____.____.2024

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM (KY PROCESVERBAL
ËSHTË PËR EFEKT PUBLIKIMI BASHKË ME DOKUMENTET E TENDERIT)**

Objekti i prokurimit: “Mbikqyrje punimesh për objektin: “Ndertim rrjeti K.U.Z Lagja Afrim, Bashkia Fier”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 71521000-6

*Vlera e fondit limit: 2,407,382 (dymilion e katërqind e shtatë mijë e treqind e tetëdhjetë e dy)
Lekë pa TVSH*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Fier SHA, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenet 26 dhe 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapaciteti profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, dhe nenin 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet (jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit).

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43 dhe nenin 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, duke mbajtur në konsideratë edhe nivelin referues të punëvs së ngjashme që kërkohet nga legjislacioni i prokurimit publik. Vlera e marzhit të xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar më sipër, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në kërkesat e Ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të

tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2024 (**kestet e maturuara**) sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësisë të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron dhe ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njësia/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: *Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1/a dhe 2, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter mbështetet edhe në legjislacionin e fushës, konkretisht, në përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, dhe në nenet 2, 4 dhe 40, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar. Nëpërmjet këtij kriteri synohet të vërtetohet që Operatori Ekonomik ofertues, e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me kuadrin rregullator dhe duke përmbushur në mënyrë korrekte detyrimet që burojnë sipas legjislacionit të fushës, pasi të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtar kanë detyrim të regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, për të bërë të identifikueshme vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshktruar pagesës së taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga ky legjislacion.

2.2.3 Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet (2022, 2023), të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

2.3. Kapaciteti teknik:

Lidhur me kapacitetet/aftësinë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se **20%**, e vleres të realizuara gjatë tri viteve të fundit:

- a. Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e mbikqyrjes, formular vlerësimi/vërtetim për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shenohen datat, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar.

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e mbikqyrjes, formular vlerësimi/vërtetim për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes ku të shënohet vlera, afati i kontratës dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar si dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar.

- *Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë edhe kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme, të deklaruara në fazën e tenderimit.*
- *Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë edhe kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor (AK), kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar nga AK si nënkontraktor.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Duke qenë se kjo procedurë prokurimi do të konkludojë me një kontratë shërbimi mbikqyrje për të dëshmuar përvojën e mëparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara në këtë kërkesë, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e shërbimeve të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për autoritetin kontraktor, me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Kjo kërkesë është në përpjestim dhe në përputhje me natyrën, objektin, fondin limit të kontratës që prokurohet, si dhe me parashikimet e bëra në legjislacionin e prokurimit publik, me qëllim për të njohur gjendjen teknike të operatorëve ekonomikë të interesuar si dhe mundësinë e tyre për të përmbushur me sukses kontratën duke u bazuar kështu në përvoja të suksesshme të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të kërkuar në këtë pikë, dokumentacion i cili parashikohet edhe nga legjislacioni në fuqi.*

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për “Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi” (lëshuar nga institucioni i autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licencave profesionale në fushën e mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit), ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme:

- NP-1 Punime gërmimi në tokë
- NP-2 Ndërtime civile dhe industriale
- NP-7a Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje
- NS-18 Punime topogjeodezike
- NS-8 (Ndertime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri)

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Kjo kërkesë është vendosur duke marrë në konsideratë shërbimet objekt kontrate. Kategoritë janë vendosur në raport me natyrën, volumin dhe përmasat e kontratës objekt prokurimi dhe shërbejnë si një garanci për Autoritetin Kontraktor për aftësinë e operatorëve ekonomikë në ekzekutimin e kontratës. Përcaktimi i kategorive të licencës profesionale të shoqërisë për “Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi” është i lidhur ngushtësisht me procesin e mbikqyrjes së të gjitha punimeve të zbatimit të objektit që prokurohet. Për ndërtimin e objektit që kërkohet shërbimi i mbikqyrjes, janë parashikuar dhe kërkuar kategori punimesh ndërtimi të përgjithshme dhe kategori punimesh speciale, sipas përcaktimeve të bëra në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Kategoritë e kërkuara për shërbimin e mbikqyrjes, janë të njëjtat kategori që janë kërkuar edhe në procedurën e ndërtimit të objektit.*

2.3.3. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf inxhinierik (drejtues teknik) për kryerjen e të gjitha shërbimeve të mbikqyrjes në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë, të figurojnë në licencën profesionale të shoqërisë për “Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi”, si dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- **1 Inxhinier Ndertimi - Konstruktor;**
- **1 Inxhinier Gjeodet;**
- **1 inxhinier Gjeolog**
- **1 inxhinier Mjedisi**
- **1 Inxhinier Hidroteknik**
- **1 Nje punonjes i pajisur me certificate trajnimi per “Parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri”**
- **1 punonjes i pajisur me certificate trajnimi per “Kontrollor i volumeve te punes”**
- **1 punonjes i pajisur me certificate trajnimi per “Testimin e performances se produkteve te ndertimit**

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri dhe formimi profesional i inxhinierëve që përbëjnë stafin kryesor teknik, është përcaktuar duke u nisur nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe mbikqyrjen e punimeve. Staf i inxhinierik që do të realizojë mbikqyrjen është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve, zërat përkatës të preventivit si dhe me projektin e zbatimit të punimeve.

2.3.4. Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Pranohen edhe standardet shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë

Certifikatat që kërkohen janë si më poshtë dhe duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

- ISO 9001: 2015, Per menaxhimin e cilesise ose ekuivalente
- ISO 14001: 2015, Per menaxhimin e cilesise se mjedisit ose ekuivalente
- ISO 45001:2018, per menaxhimin e shendetit dhe sigurise ne pune ose ekuivalente
- PASS 99:2012, Per sistemin e menaxhimit te integruar ose ekuivalente

Certifikatat duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e mësipërme, sipas natyrës së shërbimeve që marrin përsipër të realizojnë sipas aktmarrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor”, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është e rëndësishme mbikqyrësi i punimeve, të kryejë veprimtarinë e tij në përputhje me standardet e kërkuara, me qëllim për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë, janë standarde që çdo subjekt duhet ti përmbushë në veprimtarinë e tij, pasi respektimi dhe ushrimi i veprimtarisë në përputhje me këto standarde, përveçse ndikon në arritjen e suksesit të subjektit, është njëkohësisht edhe një indikator që tregon

besueshmëri për realizimin e punimeve në harmoni me standardet e cilësisë e duke mbajtur në vëmendje edhe kujdesin që duhet treguar për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit e sigurisë në punë. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë. Pra, nisur edhe nga vetë përcaktimi ligjor, kërkesat e përcaktuara sipas kësaj pike, janë në përputhje dhe harmoni me natyrën dhe përmasat e objektit që prokurohet.

2.3.5. Bazuar në njoftimin e APP me nr.5585 prot, datë 25.07.2017 “Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, si dhe rekomandimit të APP me nr.6559 prot, datë 27.06.2018, për llogaritjen e çmimit të ofertës së tyre, Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë parasysh sa më poshtë:

Vlera e ofruar duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e bëra në VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Objekti bën pjesë në grupet tarifore III.

Vlera limit prej **2,407,382** (dymilion e katërqind e shtatë mijë e treqind e tetëdhjete e dy) **Lekë pa TVSH**, është vlera maksimale e llogaritur me vlerat e tarifave maksimale për seksionet dhe grupet tarifore përkatëse.

Të gjitha ofertat me vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar dhe me vlerë më të lartë se vlera maksimale e lejuar, sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr.354, datë.11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, do të skualifikohen.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Gjithashtu, kjo kërkesë është përcaktuar duke u bazuar edhe në nenin 7, pika 1, të VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Informacion lidhur me objektin për të cilin kërkohet mbikëqyrja/supervizioni:

Të dhënat e objektit për të cilin do të bëhet mbikëqyrja e punimeve, janë si më poshtë:

Objekti: Mbikëqyrje, “Ndertim Rrjeti K.U.Z Lagja Afrim, Bashkia Fier.”

Fondi limit i punimeve të zbatimit të objektit: 145,104,028.30 (njqind e dyzet e pese milion e njqind e kater mije e njetzet e tete)**Lekë pa TVSH**.

Afati i punimeve të zbatimit: 6 (gjashte) muaj (Shënim për mbikqyrjen: Pavarësisht përcaktimit të afatit 6 mujor, afati i kësaj kontrate do të shtrihet paralelisht me afatin e kontratës së zbatimit të punimeve, duke filluar nga nënshkrimi i kontratës deri në përfundimin e plotë të punimeve të zbatimit të objektit : “**Ndertim Rrjeti K.U.Z Lagja Afrim, Bashkia Fier**”, përfshirë edhe shtytjet e mundshme të afatit, që mund të lindin gjatë zbatimit të kontratës (pa kosto shtesë për AK).

2.3.6 Operoret ekonomike duhet te kenë paisjet dhe mjetet si me poshtë:

- Gps 1 cope;
- Total station 1 cope;
- Dron per matje topografike 1 cope

a) Per pajisjet operatori ekonomik duhet te paraqesi dokumentat qe vertetojne pronesine e tyre, apo marrjen me qira te tij si psh: Fature tatimore te shitblerjes, kontrate shitblerje ose kontrate qiraje te noterizuar.

Shënim: Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 9 ne DST.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi : *Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë dhe kane ne dispozicion mjetet dhe paisjet e nevojshme per te realizuar sherbimin. Gps dhe total station duhet per te kontrolluar matjet topografike dhe punen ne terren, pasi vepra eshte kanal, dhe duhet te ndertohet duke repektuar kuotat e dhena nga projektuesi ne projekt.*

Argumentimi i specifikimeve teknike/termat e referencës:

Specifikimet teknike/termat e referencës për procedurën objekt prokurimi, janë hartuar nga specialisti i fushës në njësinë e prokurimit. Termat e referencës janë të pasqyruara në shtojcën përkatëse të dokumentave standarte të tenderit, që do të publikohen në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Në hartimin e tyre janë marrë në konsideratë kërkesat tekniko-ligjore të fushës së ndërtimit dhe mbikqyrjes së punimeve.

Specifikimet teknike janë lehtësisht të aksesueshme dhe gjenden bashkëngjitur DST në skedarët e sistemit të prokurimit elektronik.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT
